



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/04
Datë: 28.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 119 paragrafi 9. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5, paragrafit 1 lidhur me nenin 19 paragrafëve 2-3, të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ndryshuar me ligjet 04/L-111 dhe 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.15/2017, me Rregulloren Nr.16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e MEPTINIS me nr. prot. 1184, datë 27.02.2020, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shkarkohet Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Qendrore "Hekurudhat e Kosovës - Infrakos" Sh.A.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Për arsyet e cekura në memorandumun shpjegues të Ministres së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Ndërmarrjes "Hekurudhat e Kosovës - Infrakos" Sh.A.



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike
Ministarstvo Ekonomije, Zapošljavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Ulaganja
Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments

DATË/E:	25.2.2020
PËR/ZA/TO:	Qeverinë e Republikës së Kosovës
NGA/OD/FROM:	Rozeta HAJDARI – Ministre, MEPTINIS
TEMA/ SUBJEKAT/ SUBJECT:	Memorandum shpjegues për propozim-vendimin për shkakimin e Bordit të Drejtorëve të ndërmarrjes publike qendrore “Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës - Infrakos” Sh.A.

I nderuar Kryeministër Kurti,
të nderuar zëvendëskryeministra Hoti dhe Abazi,
të nderuar ministra:

Si ministre përgjegjëse, **i propozoj Qeverisë së Republikës së Kosovës ta shkarkojë Bordin e Drejtorëve të ndërmarrjes “Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës - Infrakos” Sh.A. për shkelje të detyrave fiduciare.** Këtë propozim e jap duke u mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Kosovës,¹ në Ligjin për ndërmarrjet publike,² si dhe rekomandimin e Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike,³ që mbështet Ministrinë dhe Qeverinë në ushtrimin e të drejtave të aksionarit.⁴

Më 25 shkurt 2020, Njësia ka vlerësuar se Bordi i Drejtorëve i Infrakosit ka shkelur detyrat fiduciare. Në bazë të vlerësimit, **Njësia i rekomandon Qeverisë të konstatojë shkeljen dhe t’i shkarkojë drejtorët.**⁵

Në të drejtën e qeverisjes së ndërmarrjeve, termi *detyrë fiduciare* përkufizohet si detyra për të vepruar me ndershmërinë e besnikërinë më të lartë ndaj ndërmarrjes dhe në interesin më të mirë të saj.⁶ Në aktet juridike shqip ky term është dhënë edhe si “detyra të besuara”, “detyrë e besnikërisë” dhe “detyra të mirëbesimit”.⁷ Këto detyra

1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 119.9.

2 Ligji 03/L-087 për ndërmarrjet publike, ndrysh. me ligjet 04/L-111 dhe 05/L-009 (LNP), neni 5.1.

3 Provë: Rekomandimi i NjPMNP, 25.2.2020.

4 LNP, neni 37.1.

5 LNP, neni 19.2.

6 Termi është huazuar nga anglishtja. Shih zërin *fiduciary duty* në fjalorin juridik *Black’s Law Dictionary*, 9th ed., f. 581.

7 Shih, p.sh., LNP, neni 19 (titulli); Ligji 06/L-016 për shoqëritë tregtare, neni 259.3; Ligji 04/L-034 për Agjencinë e Privatizimit, i ndryshuar, neni 13.3.

u takojnë si drejtorëve ashtu dhe zyrtarëve të ndërmarrjes.⁸ Sipas ligjit, Bordi i përgjigjet Qeverisë, kurse zyrtarët i përgjigjen Bordit, për zbatimin e detyrave fiduciare.⁹

Qeveria duhet t'i shkarkojë drejtorët menjëherë kur, me rekomandimin e Njesisë, konstaton se shkelja ka ndodhur.¹⁰ Në këtë rast, ndërmarrja duhet t'i padisë drejtorët e shkarkuar për kompensim dëmi, përveç nëse shuma që mund të realizohet është e shpërfillshme.¹¹ Qeveria duhet t'i shkarkojë drejtorët edhe pa rekomandimin e Njesisë, kur ka "arsye për të besuar" se kanë shkelur detyrat fiduciare.¹²

Ndërkaq, Bordi i Drejtorëve kërkon "hetim të hollësishëm dhe pa vonesë" kur dyshon se një zyrtar ka shkelur detyrat fiduciare dhe e shkarkon atë kur konstaton se ka bërë shkelje.¹³ Kryeshefi ekzekutiv është zyrtari më i lartë i ndërmarrjes.¹⁴

Më 3 janar 2020, Prokuroria Themelore e Prizrenit, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë ndaj kryeshefit ekzekutiv të Infracosit, Agron Thaçi, për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar. Vepra penale për të cilën akuzohet kryeshefi ka të bëjë me dëmtimin e pronës së ndërmarrjes gjatë mandatit, andaj përbën shkelje të detyrave fiduciare.

Më 8 janar, Njësia i ka kërkuar Bordit të Drejtorëve të Infracosit të hetojë kryeshefin për shkelje të detyrave fiduciare.¹⁵ Më 17 janar, Bordi ka njoftuar se ka shqyrtuar rastin, por se "nuk dëshirojmë të interferojmë" dhe se do të presë vendimin përfundimtar të gjykatës para se të marrë masa ndaj kryeshefit.¹⁶

Mirëpo Bordi nuk ka pse të presë vendimin gjyqësor. Hetimi që parashihet për shkeljen e detyrave fiduciare është i ndarë nga procedura penale. Ligji detyron Bordin të kërkojë hetim të menjëhershëm, të konstatojë shkeljen në bazë të hetimit dhe të shkarkojë menjëherë zyrtarin që ka bërë shkeljen.¹⁷ Në anën tjetër, ecuria penale mund të zgjasë edhe pas përfundimit të mandatit të kryeshefit. Kështu Bordi ka vonuar pa arsye përmbushjen e detyrimeve ligjore. Ky mosveprim është në kundërshtim me interesin më të mirë të ndërmarrjes, andaj **Qeveria ka "arsye për të besuar" se Bordi ka shkelur detyrat fiduciare.**

Për më tepër, Njësia i rekomandon Qeverisë të konstatojë se drejtorët e Infracosit kanë shkelur detyrat fiduciare, duke mos marrë masa ndaj kryeshefit Thaçi.¹⁸ Njësia rikujton se Ligji i punës lejon pezullimin e të punësuarit kur fillojnë procedurat penale ndaj tij.¹⁹ Gjithashtu, vëren se likuiditeti i ndërmarrjes ka rënë dukshëm viteve

8 LNP, nenet 19 dhe 23.

9 Po aty.

10 LNP, neni 19.2.

11 Po aty.

12 LNP, neni 19.3.

13 LNP, neni 23.

14 LNP, neni 21.3.

15 Rekomandimi, fn. 3 sipër.

16 Provë: Mesazhi me postel nga drejtori i NjPMNP, 23.1.2020.

17 LNP, neni 19.

18 Rekomandimi, fn. 3 sipër.

19 Po aty (citon Ligjin 03/L-212 të punës, neni 73.1.1).

të fundit, për çka Bordi ka bazë ta shkarkojë kryeshefin.²⁰ Prandaj, mbështetur në rekomandimin e Njesisë, **Qeveria duhet të konstatojë se Bordi i Infrakosit ka shkelur detyrat fiduciare** dhe rrjedhimisht ta shkarkojë atë.

Pas shkarkimit të bordit, Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit emëron një komision rekomandues të përbërë nga shërbyes civilë me cilësimet e caktuara në ligj.²¹ Sekretari gjithashtu cakton dhe zbaton rregullat e punës së komisionit, që përfshijnë ndalimin e konfliktit të interesit dhe metodologjinë e vlerësimit.²² Komisioni pastaj identifikon dhe ia propozon Qeverisë kandidatët për bordin e ri.²³ Ecuria e përzgjedhjes së drejtorëve duhet të jetë e hapur dhe e paanshme.²⁴

Deri në zgjedhjen e bordit të ri, Qeveria duhet që sa më shpejt të emërojë një bord të përkohshëm.²⁵ Qeveria duhet të përmbushë këtë detyrim në mundësinë e parë, duke iu përmbajtur rreptësisht kushteve dhe cilësimeve për bord profesionist dhe të pavarur.²⁶ Mbështetur në literaturën ndërkombëtare, rikujtojmë se profesionalizmi dhe pavarësia politike e organeve drejtuese të ndërmarrjeve publike është e domosdoshme për të luftuar korrupsionin dhe për të penguar kapjen e shtetit.²⁷

Për arsyet e sipërcekura, i propozoj Qeverisë që të nxjerrë vendim për të shkarkuar drejtorët e tashëm të Infrakosit dhe t'i zëvendësojë ata në mbledhjet e radhës, sipas ligjit.

Rozeta HAJDARI

Ministre

Bashkëngjitje (2):

- Rekomandimi i NjPMNP, 25.2.2020
- Mesazhi me postel nga drejtori i NjPMNP, "Informate lidhur me ceshtjen e KE te NP Infrakos", 23.1.2020

20 Po aty (citon LNP, neni 18.3).

21 LNP, neni 15.2.

22 LNP, neni 15.3.

23 LNP, neni 15.2.

24 LNP, neni 15.5.

25 LNP, neni 43.

26 LNP, neni 17.

27 Banka Botërore, *Anticorruption Transition: A Contribution to the Policy Debate* (World Bank: Washington, D.C., 2000) f. 9.

From: Shuqeri Musliu
Sent: Thursday, January 23, 2020 10:26 AM
To: Lulzim Demolli
Cc: Nazmi Zenelaj; Flutura Shala
Subject: Informate lidhur me ceshtjen e KE te NP Infrakos
Attachments: Draft PV i BOD Takim i Jashtezakonshem.docx; Opinion i Zyrës Ligjore.pdf; 42 Informim i kerkuar per linjen hekurudhore Prizren.pdf; Informat nga KE.pdf; 41 Raport lidhur me veprimet e ndermarra per mbrojtjen e prones ne Prizr....pdf

Te nderuar,

Keni qene te njoftuar lidhur me rastin e KE te NP Infrakos, qe sipas mediave i është ngritur aktakuza për keqpërdorim te detyrës zyrtare.

Pas reagimit nga ana jone është thirrur mbledhja e jashtëzakonshme nga BD me datën 09.01.2020 te NP Infrakos. Ne takimin e pare është kerkuar mendim juridik nga zyre ligjore e kompanisë, pas pranimit të këtij mendimi Bod ka mbajtur mbledhjen tjetër me datën 17.01.2020 ne te cilin është diskutuar çështja e cekur me larte edhe kanë ardhur ne ketë përfundim;

Bazuar në opinionin e zyrës ligjore për vlerësimin e rastit në aspektin menaxherial Bordi i Drejtoreve ka kërkuar nga Kryeshefi Ekzekutiv oftimin e dëshmime/ dokumenteve/ shkresave, raporteve dhe materialeve tjera të nevojshme lidhur me veprimet e ndërmarrura nga NP Infrakos për mbrojtjen e pronës së kompanisë. Kryeshefi Ekzekutiv në takimin e Bordit i ka paraqitur raportet nga departamentet dhe njësitë kompetente, dosjen e plotë lidhur me veprimet e kompanisë, marrëveshjen gjyqësore me Komunën e Prizrenit si dhe ka informuar në mënyrë të argumentuar, kronologjike dhe të detajuar Bordin e Drejtoreve. Bordi i Drejtoreve, pas sqarimeve, dokumenteve të dhëna nga KE, si dhe pas pyetjeve të parashtruara, në përputhje me ligjin për NP ka arritur në përfundim dhe konstatim se Infrakos ka ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ashtu sikurse obligohen me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës Nr.04/L-063, nenin 128. Paragrafi 2. Duke vlerësuar së në kuptimin menaxherial janë ndërmarr veprimet e nevojshme si dhe duke zbatuar parimin e “*presumimit të pafajësisë*” nuk dëshirojmë të interferojmë në procedurat Gjyqësore por do të veprimet në përputhje me vendimet e plotfuqishme gjyqësore.

Për me shume hollësi lidhur me ketë rast gjeni te bashkangjitur dokumentet ne attach.

Me respekt,

Shuqeri Musliu

Drejtor - Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndermarrjeve Publike (NJPMNP)

Ministria e Zhvillimit Ekonomik

Tel: +383 38 200 21 577 // 049 195 606

Email: shuqeri.musliu@rks-gov.net

Web: <http://mzhe-ks.net/>

From: Arsim Deliu [<mailto:arsim.deliu@kosovorailway.com>]

Sent: Wednesday, January 22, 2020 10:47 AM

E nderuar,

Në çështjen lidhur me ngritjen e aktakuzës nga Prokuroria Themelore Prizren, me dyshimin e bazuar ndaj Kryeshefi Ekzekutiv (KE) të NP Infrakos sh.a për veprën ‘Keqpërdorimi të pozitës apo autoritetit zyrtar’, pra duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, KE nuk i ka përmbushur detyrat zyrtare me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete.

NJPMNP pas njoftimit nga mediat, i është drejtuar Bordi të Drejtorëve (BD) me datë 08 janar 2020 përmes postës elektronike me kërkesë për të rishikuar pozicionin e KE-së, pas dyshimeve të ngritura se i njëjti ka vepruar në kundërshtim me detyrat e tij fiduciare gjatë ushtrimit të kompetencave menaxhuese në kompani.

NJPMNP ka kërkuar nga e BD, që konform madatit ligjor menjëherë të ndërmarrë masat ligjore në proporcion me dëmet e shkaktuara NP-së nga shkelja.

Pas kësaj Bordi i Drejtorëve(BD) ka thirru mbledhjen e jashtëzakonshme me datën 09.01.2020 te NP dhe 17.01.2020 ku është diskutuar çështja.

Nga procesverbalet potencohet se KE për BD ka ofruar:

- dëshmi/ dokumenteve/ shkresa, raporte dhe materialeve tjera të nevojshme lidhur me veprimet e ndërmarra nga NP Infrakos për mbrojtjen e pronës së kompanisë.
- raportet nga departamentet dhe njësitë kompetente, dosjen e plotë lidhur me veprimet e kompanisë, marrëveshjen gjyqësore me Komunën e Prizrenit si dhe ka informuar në mënyrë të argumentuar, kronologjike dhe të detajuar Bordin e Drejtorëve.

Bordi i Drejtorëve, pas shqyrtimit të dokumenteve të dhëna nga KE, si dhe pas pyetjeve të parashtruara, në përputhje me ligjin për NP ka konstatuar se “NP Infrakos ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ashtu siç obligohet me nenin 128, paragrafi 2 të Ligjit për Hekurudhat e Kosovës Nr.04/L-063”.

BD ka vlerësuar së në kuptimin menaxherial janë ndërmarrë veprimet e nevojshme si dhe duke zbatuar parimin e “*prezumimit të pafajësisë*” nuk dëshiron të interferojë në procedurat gjyqësore por do të veprojë në përputhje me vendimet e plotfuqishme gjyqësore.

Si rezultat i kësaj KE vazhdon me ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësitë që ka një Kryeshef Ekzekutiv në Ndërmarrje Publike.

NJPMNP si mekanizëm që mbështetet Ministrin dhe Qeverisë në ushtrimin e përgjegjësiave për NP-të, të cilat u janë dhënë atyre me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, pas pranimit të procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura të BD, konstaton se ka arsye për të besuar se rasti i KE, ka dëmtuar imazhin e kompanisë dhe se KE pas këtij rasti nuk mund të premtoj sigurim të bazës për performancën e pritur nga KE, dhe në të ardhmen, i njëjti nuk krijon një ndjenjë të besimit në mesin e atyre me të cilët ai është në kontakt, siç është paraparë në Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative, në ushtrimin e detyrës menaxheriale.

Ligji Nr.03/L-212 i Punës, që rregullon marrëdhënien e punës në ndërmarrjet publike, neni 73 specifikon rastet kur i punësuari përkohësisht mund të largohet nga puna. Paragrafin 1.1 i këtij neni përcakton se i punësuari përkohësisht mund të largohet nga puna ”**kur ndaj tij kanë filluar procedurat penale për shkak të dyshimit të bazuar të veprës penale**”.

Në menaxhimin e KE-së z. Agron Thaçi, NP Infarkos sh.a, vitin 2018 e ka përmbyllur me humbje dhe krahasuar me vitin 2017 kjo humbje është rritur. Sipas raportit vjetore të performancës për vitin 2018 edhe borxhi kundrejt kapitalit është rritur. Indikatorët tjerë kanë shënuar rënie, si dhe shqetësues është edhe likuiditeti që ka rënie të dukshme krahasuar me vitin paraprak (2017).

Prandaj, NJPMNP vlerëson se BD nuk ka vepruar edhe konform Neni 18 të Ligjit Nr.03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike, i cili përcakton Mbikëqyrjen nga Bordi i Drejtorëve, të zyrtarëve të NP-së. Derisa paragrafi 18.3 parasheh rastet kur BD duhet të veprojë ndaj KE-së, “Sido që të jetë, nëse NP dështon në arritjen e caqeve të saj të performancës për dy vite financiare radhazi, Bordi i Drejtorëve është i detyruar të marrë parasysh shkarkimin dhe zëvendësimin e KE-së. Ky veprim mund të ndërmerret edhe në mungesë të provave bindëse të neglizhencës, përveç nëse Bordi i Drejtorëve konstaton se performanca e dobët ka ndodhur kryesisht për shkak të rrethanave ose ngjarjeve negative të paparashikueshme...”.

Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve, konform nenit 37 Ligjit Nr. 03/l-087 për Ndërmarrjet Publike, ka mandat të mbështes Ministrin dhe Qeverinë në ushtrimin e përgjegjësisë për NP-të të cilat u janë dhënë atyre me këtë ligj, ndër të tjera sipas paragrafit 37.2, pika a) do të “përgatisë dhe dorëzojë Ministrin, për transmetim në Qeveri, analiza dhe rekomandime lidhur me çështjet e NP Qendrore që janë në kompetencën e Ministrin dhe/ose Qeverisë”.

Neni 19, paragrafi 2 - Zbatimi i Detyrave të Besuara (Fiduciare) të Drejtorëve, i Ligjit Nr.03/l-087 për Ndërmarrjet Publike, i riformuluar me nenin 11 të Ligji Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/l-087 për Ndërmarrjet Publike, përcakton:

19.2. Nëse Aksionari(ët) përmes Njesisë për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve konstatojnë se shkelja në fakt ka ndodhur, Aksionari(ët) (i) pas rekomandimit të Njesisë për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve menjëherë do ta shkarkojë dhe zëvendësojë drejtorin ose drejtorët përgjegjës dhe (ii) NP menjëherë duhet të kërkojë masa ligjore kundër drejtorëve të cilët kanë bërë shkeljen kurdo që provat në dispozicion me arsye supozohet se janë të mjaftueshme për ngritjen e suksesshme të një padie për kompensimin e dëmeve që i janë shkaktuar NP-së nga shkelja; megjithatë, NP nuk është e detyruar që të paraqesë padi kundër drejtorit(ëve) të cilët kanë bërë shkeljen nëse me arsye ka gjasa se shuma e kompensimit e cila mund të fitohet do të jetë më e ulët se shpenzimet të cilat me arsye pritet se do t'i ketë NP-ja gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore”.

Bazuar në këtë që u tha më lartë, NJPMNP konstaton se Bordi i Drejtorëve, nuk ka përmbushur obligimet ligjore të parapara me ligj, për mbikëqyrje të veprimtarisë së zyrtarëve të NP-së, andaj vlerësohet se ka bazë të mjaftueshme që Aksionari/Qeveria të veprojë sipas paragrafit 19.2. Ligjit Nr. 03/l-087 për Ndërmarrjet Publike.